



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 52 dt.09.05.1995

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e tij të dt.09.05.1995, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike lidhur me kërkesën për çeljen e fondeve për sistemimin me zyra të ambjenteve të Uzinës “Dajti” dhe kthimin në fond banese të godinës 2 katëshe ish shkollë dhe zyra të uzinës.

VENDOSI

1. Të miratojë çeljen e fondit prej 400.000 (katërqin mijë) lekë nga fondi rezervë i Bashkisë për ndërtimin e zyrave të reja dhe murit rrethues të kësaj uzine.
2. Të miratojë propozimin për kalim në fond banese të objektit godinë 2 katëshe (ish shkollë dhe administratë) e kësaj uzine.
3. Të miratojë listën për pajisjen me autorizim të banorëve, që do të paraqesë Seksioni i Strehimit të kësaj drejtorie sipas dispozitave ligjore në fuqi për strehimin e të pastrehëve të qytetit të Tiranës.
4. Deri sa të zgjidhet përfundimisht problemi i pronësisë së truallit të këtij objekti këtyre banorëve që do të paisen me autorizim nuk kanë të drejtë të bëjnë privatizimin e apartamenteve ku do të banojnë.

5. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Publike të ndjeki zbatimin e këtij vendimi, për të gjitha pikat e mësipërme.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

BESNIK PETRELA